



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

D.T.O
Përzbatim
29-03-22

Nr. 6098/1 prot.

Tiranë, më 29.03.2022

UDHËZIM

Nr. 02 datë 29/03/2022

MBI

PËRJASHTIMIN NGA PAGIMI I TAKSËS PËR QUMËSHËTIN PLUHUR, PËR HIRRË QUMËSHËTI DHE KREM QUMËSHËTI.

Mbështetur në nenin 479 të Vendimit nr.651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar; nenin 4 të Ligjit Nr.112/2021 "Per disa shtesa në Ligjin Nr.9975, date 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare", të ndryshuar", Udhëzimin e Përbashkët Nr.4, datë 31.01.2022 "Për përcaktimin e kriterëve, kushteve dhe procedurave mbi përjashtimin nga taksat për qumështin pluhur, për hirrë qumështi dhe krem qumështi të fabrikave të prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij"

Bazuar në pikën 1/b/i, të pjesës VIII/1, të Vendimit nr.921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për personelin e administratës doganore", i ndryshuar;

Me qëllim zbatimin korrekt të legjislacionit, për përjashtimin nga pagesa në import e taksës për qumësht pluhur, hirrë qumështi dhe krem qumështi :

UDHËZ O J:

I - KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Përjashtimi nga pagesa në import e taksës për qumësht pluhur, hirrë qumështi dhe krem qumështi zbatohet për fabrikat e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, për produkte të deklaruara:

- a) për herë të parë për qarkullim të lirë, ose
 - b) për qarkullim të lirë, pasi kanë qenë objekt i një regjimi tjetër doganor.
2. Për përjashtimet e mallrave të vendosura në qarkullim të lirë, sipas një përdorimi të përcaktuar, nuk lejohet përdorimi për qëllime të tjera, pa kryer pagesën e detyrimit të taksës kombetarte në import.

3. Autoriteti kompetent i cili lejon mospagimin e taksës në import është Drejtoria Përgjithshme e Doganave, sipas kriterëve, kushteve dhe dokumentacionit të referuar në legjislacionin në fuqi dhe në pjesën II, të këtij udhëzimi.

II. KUSHTE TË VEÇANTA

Baza ligjore: Neni 4 i Ligjit Nr.112/2021 "Per disa shtesa në Ligjin Nr.9975, date 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;
Udhëzimi i Përbashkët Nr.4, datë 31.02.2022"Për përcaktimin e kriterëve , kushteve dhe procedurave mbi përjashtimin nga taksat për qumështin pluhur, për hurrë qumështi dhe krem qumështi të fabrikave të prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij"

Përfitues: Fabrikat e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, të cilat importojnë qumësht pluhur, hurrë qumështi, krem qumështi dhe që pajisen me autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për çdo vit kalendarik.

Procedura: E thjeshtuar (pa autorizim përjashtimi).

Objekti i përjashtimit:Mallrat e përfshira në kodet e percaktuara në nenin 2 të Ligjit Nr.112/2021:

- Qumësht pluhur, të përfshirë në kodet 0402 10 19 dhe 0402 21 18 të NKM-së.
- Pije të homogjenizuara, të përfshira në kodet 0404 90 21, 0404 90 23 dhe 0404 90 29 të NKM-së.
- Hirrat e qumështit, të përfshira në nënkreun 0404 10 të NKM-së.
- Krem qumështi, të përfshirë në kreun 0402 të NKM-së.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kërkesë me shkrim ku të jetë evidentuar NIPT/NUIS për përjashtimin në import për produktet përkatës;
- Autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për përjashtimin nga taksa kombetare e qumështit pluhur, hurrës së qumështit dhe kremit të qumështit, e cila i bashkëngjitet kërkesës;
- Lista e produkteve të cilat do të importohen (lloji dhe sasia).

Njësia zbatuese e procedurës së thjeshtuar: Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës.

Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës, Sektori i Tarifës pasi shqyrton kërkesën e subjektit, verifikon dokumentacionin bashkëngjitur. Subjekti mund të dërgojë dokumentacion plotësues në email-in zyrtar: starifa.dpd@dogana.gov.al.

Sektori i Tarifës proçedon më tej me kryerjen e regjistrimit të NUIS në sistemin Asycuda World me kodin shtesë:

Kodi i proçedurës shtesë, kutia 37.b (DAV): JQP (përjashtim nga taksa kombetare QPL)

III. ZBATIMI DHE HYRJA NË FUQI

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Tarifës dhe Originës.
Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

